

KRIPORJA, KUTIA E BARNAVE. Tasi i hapeve. Aparati i tensionit në kutinë e vet plastike në formë vezake. Xhami zmadhues me rripin prej dantelle në ngjyrë të kuqe, i marrë nga perdet e Krishtlindjeve, i lidhur me tre nyje të mëdha. Telefoni me numrat jashtëzakonisht të mëdhenj. Libri i vjetër i adresave, kapaku i të cilit në lëkurë të kuqe i kishte cepat të përthyer duke zbuluar kësisoj letrën e zverdheme në brendësi. Ajo rregullon gjithçka me kujdes në mes të tryezës së kuzhinës. Ato duhet të vendosen mirë e bukur në një vijë. Mbulesa prej linoje në ngjyrë të kaltër, e hekurosur për merak, nuk duhet të ketë asnjë rrudhë.

Çast qetësie teksa hedh sytë nga rruga me mot të zymtë. Njerëzit nxitojnë, me ose pa ombrella. Pemët e zhveshura. Uji rrjedh rrëke në asfaltin e mbuluar nga lluca.

Një ketër vrapoi si shigjetë përgjatë një dege dhe sytë i ndritën nga një vetëtimë lumturie. Ajo u zgjat përpara duke ndjekur me kujdes lëvizjet e mjegulluara të krijesës së vogël. Bishti si xhufkë i tundej sa nga njëra anë në tjetrën teksa lëvizte plot gjallëri degë më degë. Më pas ketri kërcen poshtë në rrugë e zhduket me shpejtësi drejt një aventure të re.

Duhet të jetë pothuajse ora e ngrënies, mendon ajo duke fërkuar barkun. Merr xhamin zmadhues dhe me dorën që i dridhet e ngre drejt orës së artë të dorës. Numrat janë ende shumë të vegjël dhe nuk i mbetet gjë tjetër veçse të heqë dorë. Rreh duart me qetësi në prehër dhe për një çast mbyll sytë duke prititur tingullin e njohur të derës kryesore.

- Po dremisje, Doris?

Befas e zgjon nga gjumi një zë jashtëzakonisht i lartë. Ndjen një dorë mbi shpatulla dhe e përgjumur përpiqet të buzëqeshë e të përshëndesë me kokë kujdestaren e re që është përkulur mbi të.

- Me sa duket.

Fjalët i ngecën dhe kroi fytin.

- Urdhëro, pi pak ujë.

Kujdestarja nxiton t'i zgjasë një gotë dhe Doris rrufit disa gllënjka.

- Faleminderit... Më fal, po ta kam harruar emrin. Ka ardhur prapë një vajzë e re. Tjetra para saj u largua; u ishte rikthyer studimeve.

- Jam unë, Doris. Ulrika. Si je ti sot? - e pyeti ajo, por pa ndalur të dëgjojë përgjigjen.

E vërteta që as Doris nuk i dha ndonjë përgjigje.

Ajo sheh në heshtje lëvizjet e nxituara të Ulrikës në kuzhinë. E sheh tek nxjerr piperin dhe fut sërish kriporen në dollap. Në nxitim e sipër bën rrudha në mbulesën e tryezës.

- Të kam thënë, mos i shto kripë, - thotë Ulrika, me tasin e ushqimit në duar. I hedh Dorisit një vështrim të sertë. Doris tund kokën dhe psherëtin ndërkohë që Ulrika zhvesh mbështjellësen plastike. Salcën, patatet, peshkun dhe bizelet, të përziara të gjitha bashkë, i derdh në një pjatë qeramike në ngjyrë kafe. Ulrika fut pjatën në mikrovalë dhe e programon për dy minuta. Furra nis të punojë me zhurmë të mekur dhe aroma e peshkut fillon të përhapet ngadalë në apartament. Teksa pret, Ulrika nis të lëvizë gjërat e Dorisit: bën piring njëra mbi tjetrën gazetat dhe postën, nxjerr enët nga pjatatarësja.

- Është ftohtë jashtë?

Doris kthehet sërish e sheh shiun me shtamba. Nuk i kujtohet se kur ka qenë hera e fundit që ka shkelur jashtë derës. Ishte verë. Ose ndoshta pranverë.

- Poo, uh, u bë si dimër. Pikat e ujit ndjeheshin gati si kokrriza akulli sot. Jam e lumtur që kam makinë e nuk më duhet të eci. Gjeta vend në rrugën tënde, menjëherë jashtë derës. Aty ku jetoj unë në periferi, është shumë më lehtë të gjesh parkim. Këtu në qytet nuk ka shpresë, por ndonjëherë je me fat.

Fjalët rrjedhin lumë nga goja e Ulrikës e më pas zëri u shndërrua në një zukatje të zbehtë. Një këngë pop; Doris e njeh në radio. Ulrika sillet si fugë vërdallë e largohet. Po pastron pluhurat në dhomën e gjumit. Doris mund të dëgjojë rrapëllitjet e saj lart e poshtë dhe shpreson të mos përmbysi vazon, atë të pikturuarën me dorë qe e ka aq për zemër.

Kur kthehet, Ulrika mban në njërin krah një fustan. Është ngjyrë bordo, i leshtë, ai me mëngët me pufka dhe me një fije qe i varet nga pala. Doris ishte përpjekur ta këpuste herën e fundit qe kishte veshur fustanin, por dhimbja në shpinë ia bëri të pamundur të arrinte deri poshtë gjunjëve. Ajo zgjat njërin dorë për ta kapur, por i shkoi huq kur Ulrika kthehet befaz dhe e var fustanin mbi karrige. Kujdestarja kthehet sërish dhe fillon t'i zbërthejë Dorisit fustanin e shtëpisë qe mban të veshur. Ajo tërheq me kujdes e i liron njërin krah dhe Doris rënkon lehtasi kur shpina e lënduar dërgon një valë dhimbjeje deri lart në shpatulla. Është gjithmonë aty, ditënatë. Kujtesë për moshën e saj.

- Kam nevojë të çohesh në këmbë tani. Do të numëroj deri në tre dhe do të ngre, OK?

Ulrika vendos një krah rreth saj, e ndihmon të ngrihet në këmbë dhe i heq fustanin e shtëpisë duke ia tërhequr lart. Doris ka mbetur në këmbë, në kuzhinë, në dritën e ftohtë të ditës, lakuriq vetëm në të brendshme. Edhe ato duhen ndërruar. Ajo mbulon veten me njërin krah tekta i zbërthehet gjimbajtësja. Gjinjtë i bien lirshëm mbi bark.

- O e shkreta ti, u bëre akull! Eja këtu, eja të të çoj në banjë.

Ulrika e merr nga dora dhe Doris e ndjek pas me kujdes, me hapa të lëkundur. Ndjen gjinjtë t'i lëkundën, shtrëngon fort njërin krah mbi to. Banja është më e ngrohtë, falë ngrohjes qe vjen nga poshtë pllakave, heq pantoflat dhe shijon ngrohtësinë nën shputat e këmbëve.

- Mirë, eja të veshim fustanin. Ngriji krahët

Bën si i thotë, por krahët arrin t'i ngrejë vetëm deri në lartësinë e gjoksit. Ulrika e ka të vështirë me stofën e fustanit por më në fund arrin ta tërheqë e t'i nxjerrë kokën Dorisit. Kur Doris e sheh në sy, Ulrika buzëqesh.

- Kuku! Sa ngjyrë e bukur, të shkon. Do edhe pak buzëkuq? Ndoshta edhe pak pudër në faqe?

Kutia e tualetit është hapur mbi një tryezë të vogël pranë lavamanit. Ulrika merr buzëkuqin, por Doris tund kokën dhe e kthen në anën tjetër.

- Edhe sa kohë i duhet ushqimit? - pyet tekta ktheheshin në kuzhinë.

- Ushqimi! Ah! Sa budallaqe jam, e harrova fare. Më duhet ta ngroh prapë.

Ulrika nxiton te mikrovala, hap derën dhe e mbyll sërish, e programon për një minutë dhe shtyp butonin për ta ndezur. Shtie pak lëng me fruta pylli në një gotë dhe e vendos pjatën mbi tryezë. Doris rrudh buzët kur sheh qullin e trashë, por uria e bën të ngrejë pirunin e ta çojë në gojë.

Ulrika i ulet përballë me një filxhan në dorë. Atë të pikturuarin me dorë, atë me trëndafila rozë. Filxhanin qe Dori nuk e përdorte kurrë për vete nga frika se mos e thyente.

- Kafja është lëng i artë, - tha Ulrika. - A po jo?

Doris tundi kokën me sytë e ngulur te filxhani.

Mos e hidh.

- U ngope? Ulrika e pyet mbas një farë kohe qe po rrinin të ulura në heshtje. Doris pohon me kokë dhe Ulrika ngrihet të largojë pjatën. Ajo kthehet me kafën e nxehtë qe avullonte në një tjetër filxhan. Një në ngjyrë blu të errët të markës *Höganäs*.

- Me në fund! Tani mund të marrim pak frymë lirisht... hmm?

Ulrika buzëqesh dhe ulet sërish.

- Kjo kohë, shi dhe vetëm shi, shi, shi. Duket sikur s'ka për të pushuar kurrë.

Doris bën t'i përgjigjet, por Ulrika vazhdon:

- Po vras mendjen nëse lashë ndonjë palë çorape më tepër në çerdhe. Ka të ngjarë qe vogëlushët të bëhen qull sot. Fundja, duhet të kenë ndonjë palë rezervë qe mund t'i marrin hua. Do më duhet ta marr fëmijën të grindur e pa çorape. Gjithmonë do ketë ndonjë shqetësim nga fëmijët. Por ma merr mendja ti e di si është? Sa fëmijë ke?

Doris tundi kokën.

- Oh, asnjë? E shkreta, domethënë nuk ke asnjë që të viziton? Ke qenë ndonjëherë e martuar?

Këmbëngulja e kujdestares e çuditi Dorisin. Zakonisht këto gra të reja nuk bëjnë të tilla pyetje, të paktën jo kaq hapur gjithsesi.

- Po ti duhet të kesh shoqe, apo jo? Që vijnë ndonjëherë? Sidoqoftë, ai duket mjaft i trashë. - Ajo tregon me gisht librin e adresave mbi tryezë.

Doris nuk përgjigjet. Ajo ia ngul sytë fotografisë së Xhenit. Është në korridor, por kujdestarja nuk e ka vënë re kurrë. Xheni, e cila është kaq larg, e megjithatë gjithmonë kaq pranë në mendimet e saj.

- Mirë pra, dëgjo, - vazhdon Ulrika. - Më duhet të nxitoj. Mund të flasim më gjatë herën tjetër.

Ulrika fut filxhanët në pjatolarëse, madje edhe atë të pikturuar me dorë. Më pas ndez makinën, i jep edhe një të fshirë të fundit dollapit me leckën e enëve, dhe pa e kuptuar Doris del nga dera. Nga dritarja shikon Ulrikën që vesh pallton duke ecur dhe futet në një makinë të vogël të kuqe që mban logon e agjencisë mbi derë. Me këmbët zvarrë Doris i afrohet pjatolarëses dhe ndërpret larjen. Nxjerr filxhanin e pikturuar me dorë, e shpëlan me kujdes dhe me pas e fsheh në fund të dollapit, mbrapa tasave të thellë të ëmbëlsirave. E kontrollon nga çdo anë. Nuk duket më. E kënaqur, ulet sërish në tryezën e kuzhinës dhe sheshon mbulesën me duar. Rregullon gjithçka me kujdes. Kutia e barnave, pilulat, kutia plastike, xhami zmadhues dhe telefoni janë sërish në vendet e duhura. Kur zgjatet të kapë librin e adresave, dora ndalon dhe ajo e lejon të qëndrojë aty. Nuk e ka hapur prej kohësh, por tani ngre kapakun dhe ndesh një listë me emra mbi faqen e parë. Shumicës u ishte hequr vizë. Në anë, e ka shkruar disa herë. Një fjalë. *Vdekur.*